



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:276482

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05739889

**AA.nr.481/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve Z. B. S. dhe S.C. nga K., të përfaqësuar me autorizim nga S. Z. nga B. J. në Gj., kundër të paditurës, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale -Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i Vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1673/19, të datës 14.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, merr këtë;

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, e datës 09.06.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1673/19, i datës 14.03.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar ka vendosur: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Z. B. S. dhe S.C. nga K. . Në pikën II.Anulohen si të kundërligjshme vendimet e të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës Nr.prot. ... i datës ... si dhe vendimi Nr. ... i datës ... . Në pikën III. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës (MPMS – IP) shpallet jokompetent për vendosje sipas kërkesës/ankesës së paditësve Z. B. S. dhe S.C. nga K., ndërsa palët udhëzohen në kontest civil. Në pikën IV.Ky aktgjykim zëvendëson aktet e anuluarat. Në pikën V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën si të bazuar, të prish aktgjykimin A.nr.1673/19 të datës 14.03.2023, si të kundërligjshëm dhe të lë në fuqi vendimin kontestues.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative ( LKA ), gjeti se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin Nr.... të datës ..., është refuzuar ankesa e paditësit e datës 04.01.2019 dhe është vërtetuar vendimi i organit shkallës së parë Inspektoratit të Punës Nr. ... i datës ....

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi në gjykatë, duke pretenduar se i njëjti është jo ligjor dhe i njëjti të anulohet. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesorë, më datë 14.03.2023, prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij, e në mungesë të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, si të bazuar, dhe anulon vendimin e të paditurës, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, me arsyetim ndër të tjera se; vendimi i kundërshtuar, përmban të meta esenciale që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit. Kjo për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës, e paditura ka vendosur jashtë kompetencave të saj ligjore të përcaktuar me ligj.

Për të vlerësuar këtë, gjykata iu referua nenit 2 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligjit Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, teksti të pika “a” e nenit 2, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet me tekstin “*Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë*”. Nenit 79 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës.

Sipas Ligjit për Gjykatat, kompetente për shqyrtimin e lëndëve nga marrëdhënia e punës sipas dispozitës së lartcekur, janë gjykatat themelore në kontest civil, varësisht nga kompetenca territoriale.

Në bazë të nenit 4 par.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organet publike duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Paragrafi 2,3 dhe 4 i këtij neni.

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurës Inspektorati i Punës, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast, të gjykatës.

Lidhur më këtë, gjykata mori parasysh edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nr. ref. AGJ 2098/22 datë 16.12.2022.

Me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, konkretisht nenin 4.1 të të njëjtit, i cili përcakton kategoritë e punonjësve të publik të cilët nuk janë pjesë të shërbimit civil, parashihet se:

*“në bazë të këtij ligjit, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policor të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganor të Doganave të Kosovës, zyrtarët*

*korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjitha ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i presidentit, kryetarit të kuvendit, kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës, rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me Marrëveshje Kolektive ose me Rregullore Sektoriale”.*

Në bazë të kontratave të punës të paditësve të administruara si prova në këtë shqyrtim, vërtetohet se paditësit nuk e kanë statusin e shërbyesve civilë. Si rrjedhojë, procedurat e rekrutimit, rregullohen me Ligjin e Punës dhe ligjet e veçanta, andaj, për zgjidhjen e kontesteve në këtë kuptim, është kompetencë ekskluzive e gjykatave themelore në kontest civil. Duke marr parasysh këtë, gjykata vendosi që në rolin e organit administrativ të paditur, të shpallë jokompetente këtë organ dhe palën ta udhëzojë në kontest civil.

Kolegji i gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm konkludimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë si në aktgjykimin e ankimuar. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore në të cilat bazohet, sepse në bazë të provave të administruara gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktit kontestues në procedurë administrative si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, konstatohet me të drejtë se i njëjti përmban të meta esenciale, dhe nuk është i plotë dhe përmbajtjesor ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore të LPPA-së, si në nenin 47.

Sipas nenit 52 par. 1 pika 1.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar se: *“një akt administrativ është i paligjshëm nëse është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas par. 2 të nenit 4 të këtij Ligji”*, ndërsa në pikën 1.2 të po këtij par. është përcaktuar se: *“organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë”*. Në nenin 1 të Ligjit për Inspektoratin e Punës përcaktohet se: *“Autoriteti i Inspektoratit të Punës zbatohet në mënyrë unike për të gjitha vendet e punës, pavarësisht se cila dispozita ligjore janë në fuqi, e që kanë të bëjnë me kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve”* ndërsa në nenin 2 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Inspektorati i Punës është kompetent që të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, t’ju siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet me të efektshme.....etj”*.

Kolegji vlerëson se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës me vendimin e saj, ka bërë tejkalim të autorizimve ligjore në kundërshtim me nenet e lartcekura, kështu që ka marrë kompetenca gjyqësore, pasi që kompetente për të vlerësuar kthimin në punë të paditësit dhe për pagesën e të ardhurave personale nga data 01.02.2018, kompetente është Gjykata Themelore, ndërsa Inspektorati i Punës mund të shqiptoj vetëm gjoha në rast se konstaton shkelje gjatë procedurës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Andaj, duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale me rastin e aprovimit të kërkesë padisë së paditësit dhe anulimin e vendimit të organit administrativ përfundimtar në procedurë administrative, e pasi që me thëniet në ankesë, aktgjykimi i shkallës së parë nuk vihet në dyshim, ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Pretendimet ankimore të paditurit nga bazat ankimore të cekura më lartë, Kolegji i shqyrtoi në tërësi dhe i vlerëson se janë të pa bazuara, jo të qëndrueshme apo me ndikim për vendosjen e çështjes në mënyrë tjetër, sepse nuk argumentohet me asnjë provë se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës administrative dhe kontestimore, siç pretendohet, sepse nga gjykata e shkallës së parë, janë treguar dhe arsyetuar në tërësi faktet

vendimtare të bazuara edhe në bazat ligjore. Nga këto fakte rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, në bazë të pretendimeve të palëve si dhe provave materiale të gjendjes konkrete, lidhur me çështjen kontestuese mes palëve.

Mbi këtë gjendje të fakteve Gjykata e Apelit konstaton se në këtë çështje juridike administrative, drejtë janë zbatuar dispozitat e LPPA-së dhe LKA-së, dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thënie në ankesë nuk i aprovoi dhe i vlerëson se nuk janë me ndikim për vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në procedurë gjyqësore, dhe nga organi administrativ i shkallës së parë.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AA.nr.481/2023, datë 21.05.2024**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Delushe Halimi**